

LIGJ
Nr. 147/2020

PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7905, DATË 21.3.1995,
“KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 75/a, në shkronjën “a”, pas fjalëve “dhe 319/e” shtohen fjalët “, si dhe nenet 328 dhe 328/b, të Kodit Penal”.

Neni 2

Neni 189 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 189

Ruajtja e provave materiale

Provat materiale, që për shkak të natyrës së tyre mund të ndryshojnë, në qoftë se nuk mund t’u kthehen personave që u përkasin, ruhen e administrohen sipas legjislacionit të posaçëm nga organi administrues shtetëror, i cili detyrohet t’i kthejë të njëjlojta ose të japë vlerën e tyre.”.

Neni 3

Në nenin 214 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalia e dytë, ndryshohet, si më poshtë:

“Kur kjo nuk është e mundur ose e përshtatshme, organi procedues urdhëron që ato të ruhen pranë organit administrues shtetëror, duke përcaktuar mënyrën e ruajtjes.”.

2. Pika 2, ndryshohet, si më poshtë:

“2. Organi administrues shtetëror ka për detyrë ruajtjen dhe administrimin e sendeve të sekuestruara, sipas legjislacionit të posaçëm për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe provave materiale, si dhe të paraqesë sendet kur kërkohen nga organi procedues.”.

Neni 4

Në nenin 215, pika 3, ndryshohet, si më poshtë:

“3. Për sendet që mund të ndryshojnë, me kërkesë të organit administrues shtetëror ose kryesisht, organi procedues urdhëron, sipas rastit, tjetërsimin ose asgjësimin e tyre.”.

Neni 5
Dispozitë kalimtare

1. Provat materiale, për të cilat vendimi përfundimtar i organit procedues nuk ka disponuar sipas pikës 1, të nenit 190, të Kodit të Procedurës Penale, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kalojnë në favor të organit administrues shtetëror dhe administrohen sipas legjislacionit të posaçëm për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe provave materiale.

2. Provat materiale, sipas pikës 1 të këtij neni, për të cilat kanë kaluar pesë vjet nga vendimi përfundimtar, asgjësohen, me urdhër të gjykatës, pas kërkesës së organit procedues, sipas pikës 6, të nenit 215, të Kodit të Procedurës Penale, duke ruajtur kampionet përkatëse.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020

**Shpallur me dekretin nr. 11905, datë 8.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**